



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 211 dt.20.10.1994

**MBI**  
**DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN SHTATOR 1994**

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, V.K.M. Nr.622, dt.31.12.1993 “Për dhënie e ndihmës ekonomike” V.K.M. Nr.311, dt.11.07.1994, “Për përfitimin e paaftësisë”, pika.7 dhe Udhëzimi Nr.9, dt.23.02.1994 të Ministrisë së Punës Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.20.10.1994, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore,

**VENDOSI**

1. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike 63 familje, të cilat nga verifikimi u konstatua se ishin në marrëdhënie pune, kishin makina private, mirëqënie, ishin të larguar jashtë shtetit etj.  
Sipas pasqyrës së bashkangjitur.
2. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin shtator 1994 gjithsej 12.469 familje me një fond prej 34.2 milion lekë, nga të cilat :

1.Me ndihmë të plotë 11.554 familje me një fond prej 33 milion lekë

2.Me ndihmë të pjesshme 915 familje me një fond prej 1.2 milion lekë.

E detajuar sipas njësive administrative në pasqyrën e bshkëngjitur vendimit.

3. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar, në masën 1.344 lekë në muaj 15 familjet e mëposhtëme :

- ArturÇollaku, Nj.A.1
- Theodhor Livareto, Nj.A.2
- Agim Hysa, Nj.A.2
- Shkëlqim Doma, Nj.A.2
- Beqir Haluli, Nj.A.4
- Merita Shtina, Nj.A.5
- Ilir Dervishi, Nj.A.5
- Bexhet Veshi, Nj.A.5
- Muharrem Marra, Nj.A.5
- Muharrem Goxherri, Nj.A.7
- Irfan Gostivari, Nj.A.7
- Idriz Cako, Nj.A.7
- Agim Sako, Nj.A.9
- Eqerem Konçi, Nj.A.9
- Ali Plaka, Nj.A.11

4. Të përfitojnë ndihmë ekonomike si raste të veçanta :

- Bujar Qulafku, me 4 anëtarë, me ndihmë të plotë max. Nj.A.2
- Edmond Manasopite, trajtohet për 3 muaj, Nj.A.7
- Jonuz Kepusta, me 7 anëtarë, ndihmë e plotë, me max. Nj.A.8
- Vasil Muçi, me 1 anëtarë ndihmë e plotë, Nj.A.10

5. Të ndërpritet ndihma ekonomike familjeve :

- Xhevdet Krasniqi, Nj.A.1, familje me 5 anëtarë. Të njoftohet që brenda datës 15 nëntor të kthejë lekët e

marra padrejtësisht, në të kundërt do të kthejë 3 fishin e shumës së përfituar.

- Gëzim Beçoku, Nj.A.7, familje me 3 anëtarë, të kthejë lekët e marra për 3 muaj.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen :

- Seksioni i Mbrojtjes Shoqërore, administratorët dhe pagatorët e njësive administrative.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**